



Këshilla
Si mund të
pini më shumë
ujë çdo ditë

NË FAQEN 15



Pyetja
Çfarë të vesh?!
U merr 6 muaj
jetë femrave

NË FAQEN 16



Histori
Gjenocidi që
Gjermania refuzon
t'ia njohë vetes

NË FAQEN 19



Gazeta Shqip
ABONIMI

Shqip



Adresa e redaksisë: Rr. Pesë Dëshmorët,
Nr. 20, Gazeta Shqip, Mëzez, Tiranë
Tel: 069 20 35 300 • 066 20 35 300
E-mail: info@gazeta-shqip.com

Drejtor BESNIK MYTARË

Viti XI - Nr. 158 (3680)

E premte, 10 qershor 2016

E përditshme e pavarur

Çmimi 30 lekë

www.gazeta-shqip.com

Kreu i mazhorancës paralajmëron rrjedhje votash: Do gjejmë një vëlla këtej dhe një andej për reformën. Kryediplomati gjerman, në Tiranë për të gjetur zgjidhje

Rama: "Drejtësia", me çdo kosto

Kuvendi e planifikon në kalendarin 3-javor, PD: Skandal, do e çojmë në prokurori

Boshatiset Kuvendi, ministra e deputetë në Francë
PD hakmerret për Berishën,
kërkon përjashtimin e Ramës



NË FAQEN 4

NEOSHQIPTARIZMA,
NJË MODEL I HUAZUAR

ENIS SULSTAROVA

Ndër intelektualët më në zë të viteve '20-'30 të shekullit të kaluar, Branko Merxhani, mbetet akoma një figurë plot të panjohura. Enigmatik ishte edhe për bashkëkohësit, të cilët hamendësonin për prejardhjen e tij familjare pa treguar ndonjë të dhënë të sigurt. Edhe krijimtarinë e tij nuk e kemi të plotë në duar. Vëllimi Vepra përmban publicistikën e tij në shqip...

NË FAQEN 9

Kryeministri Edi Rama paralajmëron votimin e reformës në drejtësi dhe pa opozitën. Deklarata e numrit një të qeverisë u bë dje në seancën parlamentare, e cila la të nënkuptohet se ajo do të realizohet edhe me mbështetjen e ndonjë deputeti të opozitës, pra duke pasur rrjedhje votash në kampin e djathtë. "Sot do të shkoj në Francë dhe do t'i bëj të fala edhe nga ju të gjithë, Ekipit Kombëtar të Futbollit. Juve e di që do të ikni pa lejen..."

NË FAQET 2-3

KQZ

Bushi e Rroshi çohen në prokurori për verifikim

Mosdorëzimi në kohë i formularit të dekriminalizimit nga Edmond Leka që do të zëvendësojë Koço Kokëdhimën në grupin parlamentar të...

NË FAQEN 5

Kreu i SHISH takon Lallën për hetimet, këqyren kamerat e repartit special

Përgjimet, përgjigjet Italia:
Pajisja, vetëm për lokalizim

Për të dytën ditë me radhë, krerët e mazhorancës përplasen me gjyqësorin

Tahiri, Nishanit: Pse u zgjodh Aliaj për Çakon? Gjyqtarët: Na lini të punojmë

NË FAQEN 7

Një ditë pasi prokuroria shqiptare i drejtoi tetë pyetje policisë italiane, për të ashtuquajturën pajisje përgjimi, ka ardhur edhe përgjigja. Me një letër të publikuar dje nga Ministria e Brendshme, citohet se me pajisjen "Imisi Catcher" nuk mund të kryhet asnjë lloj përgjimi. Pavarësisht kësaj letrë, burime nga akuza qendrore pohojnë se do të vazhdojnë hetimet, deri në zbardhjen e plotë të të gjithë aktivitetit të të dyshuarve. Mësohet se letra zyrtare është firmosur nga drejtuesit e lartë të policisë italiane...

NË FAQEN 6

Urdhri

Denoncimi i "Fiks Fare" për dhunën në burgje, shkarkohet përgjegjësi



NË FAQEN 8

Tregu farmaceutik

Konkurrenca nis hetimet për monopolin e insulinës

Autoriteti i Konkurrencës ka nisur një hetim të thelluar mbi kompaninë që ka ekskluzivitetin e tregimit të insulinës për abuzim me pozitën monopol. "Fufarma" është kompania e vetme që ka të drejtën e tregimit të insulinës 'lantus' në Shqipëri...

NË FAQEN 10

Turneu

Sot në orën 21:00 në Paris, ndeshja Francë-Rumani pret "shiritin" e Europeanit
Basha: Dimë se ku ta godasim Zvicrën

Ndeshja ndaj Zvicrës po afron dhe stresi me emocionet e futbollistëve të kombëtares sa vjen e shtohet. Të gjithë janë të fokusuar për sfidën që do të luhet të shtunën në Lens kundër Zvicrës së Petkoviçit, por Migjen Basha bën apel që të mos kalohet në eufori. Mesfushori kuqezi nga grumbullimi i ekipit në "Perros Guirec", nuk i fsheh emocionet në prag të një sfide...

NË FAQEN 21



Graf: Për herë të parë, dy vëllezër kundër njëri-tjetrit

Ambasadori i Zvicrës: Përballja me Shqipërinë, ndeshje historike

NË FAQEN 20

Debati



A është vjedhje ripublikimi i shkrimeve online?

ARTA MARKU

NË FAQEN 22

Operacioni

Çapjat: Kujtuam se ramë në pritë. Policia: I paralajmëruam Sulmi ndaj policisë, pranga 3 "luftëtarëve" e 5 ndihmësve

NË FAQEN 11

REVISTA SARAS

WWW.REVISTASARAS.AL

/revistasaras

Intervista

Ambasadori i Zvicrës: Përballja me Shqipërinë, një ndeshje historike

Graf: Për herë të parë, dy vëllezër kundër njëri-tjetrit

RUDINA HOXHA

Në prag të ndeshjes së shumëpritur të futbollit midis Shqipërisë dhe Zvicrës me datë 11 qershor në kuadër të Kampionatit European të Futbollit 2016, ambasadori zviceran në Shqipëri, Christoph Graf, ka ndarë mendimet e tij me lexuesit e gazetës "Shqip" rreth pritshmërive për këtë "ndeshje historike" siç do ta quante ai.

"Ndeshja është historike: për herë të parë, dy vëllezër do të luajnë kundër njëri-tjetrit në dy skuadra të ndryshme në një tur të një niveli kaq të lartë. Dhe mos të harrojmë se kjo është hera e parë që Shqipëria kualifikohet për një kampionat të një niveli të lartë. Është një arritje e madhe!", tha Graf.

Me këtë rast, ambasadori nënvizon se Ambasada Zvicerane në Tiranë do të organizojë edhe shfaqjen e ndeshjes në një ekran të madh për një rreth miqsh. "Është një mundësi unike për të festuar marrëdhëniet e afërta dhe miqësinë midis Shqipërisë dhe Zvicrës".

Por përveç kësaj, ambasadori Graf komenton në këtë intervistë edhe çështjet më të nxehta politike dhe ekonomike që shqetësojnë vendin aktualisht.

Z. Ambasador, Kampionati European 2016 po afron shpejt. A është futbollit një nga pasionet tuaja? Kush është skuadra juaj e preferuar e futbollit?

Më pëlqen shumë futbollit. Unë jam një tifoz besnik i një skuadre zvicerane që quhet Young Boys nga Berna. Deri dy vite më parë isha një mbështetës i rregullt në stadium bashkë me djalin tim. Më pëlqen futbollit, sepse është një lojë për popullin. Si lojtarët ashtu edhe spektatorët ndajnë gëzimin, pavarësisht moshës, statusit shoqëror, kulturës apo origjinës: zyrtarë të lartë dhe shefa kompanish krahas për krahas me punëtorët dhe të rinjtë. Futbollit është gjithashtu një lojë skuadre. Mund të fitosh vetëm bashkë me të tjerët, varesh nga kolegët e tu. Humbjet i duron si grup dhe fitoret i feston bashkë me të tjerët. Jam i bindur se kjo sjellje rrezatohet gjithashtu edhe në sfera të tjera të jetës.

A po flasin zviceranët shumë mbi ndeshjen që po pritët midis Shqipërisë dhe Zvicrës? Çfarë emocione keni kur shihni pritshmëri të mëdha për këtë ndeshje në Shqipëri?

Në Zvicër, si dhe midis zviceranëve që jetojnë në Shqipëri ka një interes të madh mbi ndeshjen e të shtunës. Tek ambasada zvicerane në Tiranë ne po organizojmë një shfaqje në ekran për miqtë. Është një rast i veçantë për të festuar lidhjet e ngushta dhe miqësinë midis Shqipërisë dhe Zvicrës. Kjo ndeshje është historike: për herë të parë dy vëllezër luajnë kundër njëri-tjetrit në skuadra të ndryshme në një përballje të këtij niveli. Dhe të mos harrojmë që kjo është hera e parë që Shqipëria kualifikohet për një kampionat të nivelit të lartë. Kjo është një arritje e madhe!

Një delegacion parlamentar zviceran mori pjesë në Asambleenë Parlamentare të NATO-s që u zhvillua në Tiranë për herë të parë (28-30 maj, 2016). Cili ishte qëndrimi dhe idetë e Zvicrës mbi këtë ngjarje të rëndësishme?

Zvicra është një vend asnjans dhe ne mbështesim planin e sigurisë së NATO-s si anëtar të "Partneritetit për Paqe". Kjo marrëveshje fleksibël e bashkëpunimit me NATO-n i përshtatet si vendeve anëtare të NATO-s ashtu edhe Zvicrës. Për shembull, në tre të ashtuquajtura "Qendra të Sigurisë" në Gjenevë Zvicra ofron platforma

Ambasadori nënvizon se Ambasada do të organizojë edhe shfaqjen e ndeshjes në një ekran të madh për një rreth miqsh. "Është një mundësi unike për të festuar marrëdhëniet e afërta dhe miqësinë midis Shqipërisë dhe Zvicrës"

ndërkombëtare për dialogun mbi çështjet e politikave të sigurisë.

Në mes të debateve mbi reformën në drejtësi, ambasada zvicerane dhe Ministria e Jashtme e Shqipërisë zhvilluan një forum interesant - "Të Investosh në Shqipëri: Sfidat dhe Mundësitë". Cilat janë përshkrimet tuaja nga ajo që u diskutua dhe nga përfundimet? Si e shohin investitorët zviceranë Shqipërinë?

Ky aktivitet i organizuar nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë dhe i mbështetur nga Zvicra debatoi mbi mundësitë dhe sfidat që investitorët kanë në Shqipëri. Unë vura re se kishte shumë pjesëmarrës "institucionalë" si AIDA, dhomat e tregtisë, shoqata, por jo shumë sipërmarrës dhe investitorë. Një investitor zviceran foli mbi përvojën e



tij 10-vjeçare në realizimin e një projekti madhor turistik në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe ai grumbulloi rreth 40 kg letër nga lejet, vërtetimet dhe dokumentet ligjore. Kjo tregon se barra administrative është ende shqetësim për investitorët. Ai është i pasionuar pas vendit dhe ndau me të pranishmit se nevojitet këmbëngulje dhe durim për të investuar këtu. Për biznesin privat sfida më e madhe mbetet sundimi i duhur i ligjit: investitorët kanë nevojë të ndihen të sigurt, ata duan të bëjnë biznes në një mjedis të parashikueshëm. Në këtë kontekst, reforma e drejtësisë është urgjente, por në të njëjtën kohë miratimi i saj në Parlament është vetëm hapi i parë; zbatimi do të kërkojë përpjekje të mëdha dhe mbështetje të besueshme politike.

'Shija' zvicerane duket më e fortë në Shqipëri kohët e fundit. A ka ndonjë arsye për këtë? Jeni i kënaqur me nivelin aktual të marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Zvicrës?

Zvicra është e interesuar për një Ballkan Perëndimor të qëndrueshëm dhe të përparuar që shkon drejt integritimit më të ngushtë me Europën. Futbollit në këtë rast ndihmon duke sjellë Shqipërinë në hartë dhe më afër Europës! Marrëdhëniet midis Zvicrës dhe Shqipërisë janë të shkëlqyera. Ato ende fokusohen në projekte zhvillim e bashkëpunimi. Zvicra mbështet popullin shqiptar me rreth 20 milionë euro në vit përmes rreth 25 projekteve. Unë do të isha shumë i kënaqur që të shihja të zhvendosej ky fokus nga grantet e bashkëpunimit drejt shkëmbimeve tregtare dhe ekonomike. Por kjo varet shumë nga përmirësimet e klimës së biznesit në Shqipëri.

Pak kohë më parë ju krijuat tituj në media me deklaratën 'Mos prisni mrekulli nga

Zvicra'. Në pikëpamjen tuaj, çfarë duhet të ndryshojë në mendësinë e institucioneve dhe njerëzve në Shqipëri për sa i përket metodës së punës?

Janë shqiptarët ata që duhet të formojnë dhe të vendosin mbi reformat për të ardhmen. Komuniteti ndërkombëtar është i gatshëm të mbështesë. Shqipëria ka bërë përparim në 25 vitet e fundit. Pyetja është: a mund të përparoni më shpejt dhe më thellë? Më shpejt duke hequr polarizimin e panevojshëm në marrjen e vendimeve politike, dhe më thellë duke konsultuar me qytetarët në një formë më të gjerë, duke qenë më gjithëpërfshirës. Qytetarët shqiptarë e dinë mirë se çfarë duan dhe çfarë është mirë për vendin. Unë i nxis politikanët të dëgjojnë më me kujdes zërat e njerëzve dhe nxis njerëzit që të kërkojnë më shumë transparencë dhe llogari. Ligjshmëria dhe besueshmëria e institucioneve të shtetit janë thelbësore në një demokraci funksionale. Një tjetër çështje që vërej: shqiptarët shpesh i bazojnë pozicionet e tyre mbi thashetheme, perceptime dhe madje teori komplotesh, në vend të fakteve dhe shifrave. Ka shumë rëndësi që të dhëna të besueshme, burime të pavarura, dhe anketimet të jenë të disponueshme për publikun.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Milva Ekonomi, së fundmi njohu meritat e bashkëpunimit zviceran në zbatimin e modeleve të biznesit nga poshtë-lart në fushën e turizmit. Si e karakterizoni bashkëpunimin dypalësh në këtë dhe fusha të tjera?

Bashkëpunimi zviceran ndjek qasjen nga poshtë-lart, duke forcur konsultimet, duke dëgjuar zërat e njerëzve. Besoj se një pronësi më e gjerë sjell rezultate të qëndrueshme. Le të marrim si shembull reformën territoriale-administrative. Ai proces pati një shkallë relativisht të gjerë të konsultimeve. Zvicra mbështet mekanizma gjithëpërfshirës në marrjen e vendimeve, qoftë në fushën e turizmit, në qeverisjen vendore apo në shëndetësi.

Zvicra është një shtet federal me katër gjuhë dhe grupe të ndryshme etnike. Megjithatë ka arritur të zhvillojë dhe të ruajë harmoninë pavarësisht ndryshimeve etnike, gjuhësore dhe kulturore. Cili është sekret i kësaj?

Ne e shohim diversitetin si pasuri dhe si kapital. Ne na duhet të merremi me mënyra të ndryshme të të menduarit dhe me vlera të ndryshme çdo ditë. Kjo është një sfidë e vazhdueshme dhe në të njëjtën kohë pasuruese, ne mësojmë nga të tjerët. Shqipëria gjithashtu ka një kulturë të pasur dhe me të ndryshme. Diversiteti fetar në Shqipëri është ndërtuar mbi një recetë të ngjashme me diversitetin gjuhësor në Zvicër. Fjala kyçe është toleranca. Mos lufto kulturat e tjera, por merru me to dhe mëso prej tyre. Ndërtoni mbi avantazhet që keni dhe vazhdoni t'i ushqeni ato.

